



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2460/2 prot

Datë 10.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr REF-74324-07-05-2023 me objekt “**Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II**” me fond limit 208,333,221.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-07-2023 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “ALBAVIA” SHPK
Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Në datën 06.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3476 dhe me nr. 2460/2023 prot., datë 09.10.2023 e operatorit ekonomik “ALBAVIA” SHPK, për procedurën e prokurimit E hapur”, me nr REF-74324-07-05-2023 me objekt “Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II” me fond limit 208,333,221.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-07-2023 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomike “ALBAVIA” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) **arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimes “ALBAVIA” SHPK në ankesën nr. 2460 datë 09.10.2023, pretendon se i përmbush.

Arsyet e Skualifikimit nga AK:

Operatori ekonomik “Albavia sh.p.k” shpk nuk ploteson kriterin teknik 2.3.1 të DST, për kapacitetin teknik, ku parashikohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Konkretisht, elementet e kerkuar për këtë procedurë prokurimi si të ngjashem nuk plotesohen si pjesë e kontratave të punimeve të paraqitura nga operatori ekonomik, në vijim duke shkeputur zerat e punimeve si urat etj të kontratave të paraqitura brenda afatit të kerkuar nuk e arrijn vlerën e kerkuar sikurse të percaktuar në pikën 2.3.1 (a) dhe 2.3.1 (b) të Dokumentave Standarte të tenderit (Nderhyrje në Nderimin e Urave dhe Nyjeve Lidhese Faza II). Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kerkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.10.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri